



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL.Anr.48/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevcu anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Pejë, për shkak të vendosjes së posterave të kandidatëve në hapsira publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 25.09.2017, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës dega në Pejë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 700.00 (shtatëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit

#### **A r s y e t i m**

Me datën 23.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se me datën 22.09.2017, në rrugën “Mbretëresha Teutë” në Pejë, në vendin i cili është pronë dhe vend i rezervuar për shpalljen e akteve reale të Komunës së Pejës ishte vendosur poster i kandidatit për kryetar dhe kandidatëve për asamble të Komunës së Pejës.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 pika b), të LPZ-së, të dispozitës së nenit 4.1 pikës b të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 24.09.2017, subjekti politik LDK, ka theksuar se ankesa është e pabazuar, për faktin se nuk ka asnjë mbështetje ligjore por thjesht është ushtruar sa për të atakuar politikisht dhe materialisht subjektin rival të tyre-LDK.

Gjithashtu, ka theksuar se posteret janë vendosur në një hapsirë e cila është e dedikuar për reklamime të tilla nga ana e komunës, por pavarësisht kësaj, LDK ka theksuar se ka ndërmarr masat e duhura dhe ka evituar shkeljen e supozuar të ligjit dhe rregullave zgjedhore.

Në mbështetje të pretendimëve ka bashkangjitur fotografit me të cilat shihet se janë larguar posterat nga vendi ku kanë qenë të vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidatit për kryetar dhe kandidatëve për asambleist të subjektit politik LDK-së, janë vendosur në hapësira publike përkatësisht në vend të rezervuar për shpalljen e aktëve reale të Komunës së Pejës, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapësira apo në rrugë publike”*

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterit për kryetar dhe kandidatëve për asambleist të subjektit politik LDK-së, janë vendosur në vend të rezervuar për shpalljen e akteve reale të Komunës së Pejës.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara, që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti posterët për kryetar dhe kandidatëve për asambleist të këtij subjekti politik janë vendosur në hapësirë dhe në rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që se subjekti politik në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin nga vendi i palejuar ku ka qenë i vendosur ai, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

ZL.Anr.48/2017 më datën 25.09.2017.

**Kryesuesi i Panelit**

**Gyltene Sylejmani**



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk rejonet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.